



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 228/4 prot.

Datë 25.02.2026

V E N D I M
Nr. 307/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshmik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk” në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA” me fond limit 158,297,370.00 (Njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ARISA - KONFEKSION” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA” me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “ARISA - KONFEKSION” SHPK me NIPT J61828068L dhe adresë Rruga 5 Maji, Nd. 82, Hyrja 7, Tiranë.

BOE “MALBERTEX shpk” me NIPT K71821009N dhe adresë Tirane Tirane Tirane, TIRANE, SIRI KODRA BLL.MAGAZINAVE, Tiranë & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”.

Autoriteti Kontraktor: ILLYRIAN GUARD SH.A. me adresë Rruga Ibrahim Rugova, Tiranë 1016

Subjekt i interesuar: OE “Vojsava Zeneli” P.F., NUIS L12330004A, me adresë Bulevardi “Gjergj Fishta”, kulla nr. 2, kati i dytë, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.6. Ankimuesit nuk plotësojnë kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Për ankesën me nr. 228/2026 protokoli, datë 26.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6277 e BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Për ankesën me nr. 264/2026 protokoli, datë 28.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6288 e operatorit ekonomik “ARISA – KONFEKSION shpk”, nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.06.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA” me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A..

II.2. Në datën 29.08.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 16.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e **vlerësimit** të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. Arisa Konfekcion Sh.p.k 132,345,000 lekë I skualifikuar
2. BOE “Univers Promotion” shpk-Malbertex sh.p.k 98,430,000 lekë I skualifikuar
3. Vojsava Zenelaj P.F. 138,720,000 lekë I kualifikuar

II.4. Në datën 23.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 55, datë 29.09.2025, ku fitues rezulton operatori ekonomik Vojsava Zenelaj P.F.

II.5. Në datë 18.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1702/2025, ku vendosi:

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.
2. Të pranohet ankesën e paraqitur nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi.
3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë operatorin ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK, sipas konstatimeve në këtë vendim.
4. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë BOE ankimues “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, sipas konstatimeve në këtë vendim.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.6. Në datë 07.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.24/2026, ku vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.7. Në datën 09.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e **Ri-vlerësimit** të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. Arisa Konfeksion Sh.p.k 132,345,000 lekë I skualifikuar
2. BOE “Univers Promotion” shpk-Malbertex sh.p.k 98,430,000 lekë I skualifikuar
3. Vojsava Zenelaj P.F. 138,720,000 lekë I kualifikuar

II.7.1. BOE “Univers Promotion” shpk-Malbertex sh.p.k është njohur me arsyet e **Ri-skualifikimit** të ofertës së paraqitur prej tyre, me argumentet si më poshtë vijon:

“Ne baze te vendimit nr.1702/2025 te KPP me nr prot, 2645/11, date 18.11.2025 Prot me tonen me nr,187/101, date 21.11.2025. Sipas rivlersimit date 30.12.2025 me nr prot 187/112 -oferta e BOE “MALBERTEX” shpk, dhe “UNIVERS PROMOTIONS” shpk është e kualifikuar sipas vendimit të KPP, por si AK mendojme se si ofertë anomalisht e ulët që nuk krijon bindjen se është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Materialin e argumentuar e gjeni ne procesverbalin fizik”.

II.8. Në datën 19.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 07, datë 26.01.2026, ku fitues rezulton operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj P.F”.

II.9. Në datën 26.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 228/2026 protokollit, datë 26.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6277 e BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, e cila figuron me **statusin e pa paguar mandat pagesa**, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së BOE ankimues, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.9.2. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 228/1 prot., datë 27.01.2026 lidhur me arsyet e skualifikimit të BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 228/2026 prot., datë 26.01.2026.

II.10. Në datën 27.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 252/2026 protokollit, datë 27.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6282 e BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, ku janë të njëjtat pretendime si në formular ankese me numër ankimi elektronik A/2026/6277, me **statusin e paguar mandat pagesa**, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së BOE ankimues, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.10.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 252/1 prot., datë 28.01.2026 lidhur me arsyet e skualifikimit të BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 252/2026 prot., datë 27.01.2026.

II.10.2. Operatori ekonomik, subjekt i interesuar “Vojsava Zenelaj” PF, ka dërguar nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike “Formular Argumentash”, të protokolluar me nr. 252/2 prot., datë 02.02.2026.

II.11. Në datën 28.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 264/2026 protokoli, datë 28.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6288 e operatorit ekonomik “Arisa Konfeksion” shpk, e cila figuron me **statusin e pa paguar mandat pagesa**, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimes, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.11.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 264/1 prot., datë 29.01.2026 lidhur me arsyet e skualifikimit të OE “Arisa Konfeksion shpk”, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 264/2026 protokoli, datë 28.01.2026.

II.11.2. Operatori ekonomik, subjekt i interesuar “Vojsava Zenelaj” PF, me anë sistemit elektronik të ankesave online, ka dërguar “Formular Argumentash”, të protokolluar me nr. 264/2 prot., datë 03.02.2026.

II.11.3. Nëpërmjet shkresës me nr. 69/14 prot., datë 02.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 264/3 prot., datë 04.02.2026 me objekt “Vendim”, (Vendimi i KSHA nr. 69/11 datë 02.02.2026), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Arisa Konfeksion shpk”, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka dërguar informacion mbi trajtimin e ankesës së BOE ankimes “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, me objekt “Vendim”, (Vendimi i KSHA nr. 69/13 datë 02.02.2026), ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë.

II.11.4. Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se, statusi i pagesës për ankesën me nr. 264/2026 protokoli, datë 28.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6288 e operatorit ekonomik “Arisa Konfeksion” shpk, rezulton “**Paparaqitur mandat pagesë**”. Me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP me shkresën nr. 264/5 prot., datë 09.02.2026 nga KPP ju kërkua informacion autoritetit kontraktor për sa më poshtë vijon:

... me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon të informohet në lidhje me administrimin e kësaj ankese pranë institucionit tuaj si dhe veprimet procedurale të kryera nga ana juaj sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në lidhje me plotësimin e të metave të ankesës...”.

II.11.5. Me shkresën nr. 264/6 prot., datë 16.02.2026 lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së OE “Arisa Konfeksion” Shpk, Sekori i Financës informon ndër të tjera se: “ [...] Për ankesën me nr. 264/2026 protokolli, datë 28.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6288, OE “Arisa Konfeksion” Shpk, nuk ka paraqitur dokument bankar në seksion mandat pagese. Në vijim të shkresës tuaj janë kryer verifikime me raportin e datës 16.02.2026 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 11.02.2026, ku rezulton se, OE “Arisa Konfeksion” Shpk **nuk ka kryer pagesë** për ankesën e sipërcituar në favor të Komisionit të Prokurimit Publik” ...

II.11.6. Nëpërmjet shkresës me nr. 69/28 prot., datë 17.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 264/7 prot., datë 18.02.2026 me objekt “Kthim përgjigje mbi kërkesën për informacion nr.264/5 prot., datë 09.02.2026”, (Vendimi i KSHA), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatori ekonomik ankimues “Arisa Konfeksion shpk”, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë për shkak të **mosplotësisimit të kushteve formale** siç është dokumenti bankar “mandat pagesa”, duke mos marrë parasysh këtë formular ankese.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Nga shqyrtimi i ankesës me nr. 228/2026 protokolli, datë 26.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6277 e BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk” dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se BOE ankimues nuk ka bashkëlidhur dokumentin bankar që të vërtetojë, se ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me përcaktimet në pikat 2 dhe 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III.1.1. Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.2. Në pikën 2 gërma “a”, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;”

III.1.3. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efijencës në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Fakti që nuk ka korrigjuar të metat e ankesës, si në rastin konkret pagimin e tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit. Referuar arsytimit, në kushtet kur BOE ankimues nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës, Komisioni gjykon, se ankesa me nr. 228/2026 protokoli, datë 26.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6277 e BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, nuk plotëson një prej

elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kjo ankesë duhet refuzuar.

Komisioni thekson faktin se, BOE ankimues përsëri, në datën 27.01.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 252/2026 protokolli, datë 27.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6282 e BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, e cila është e shoqëruar me mandat pagese bankare, ku u konstatua se objekti i saj, është i njëjtë me atë të me nr. 228/2026 protokolli, datë 26.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6277.

III.2. Lidhur me arsyet e skualifikimit të BOE ankimues “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, se: *“Ne baze të vendimit nr.1702/2025 të KPP me nr prot,2645/11, date 18.11.2025 Prot me tonen me nr,187/101, date 21.11.2025 Sipas rivlersimit date 30.12.2025 me nr prot 187/112 -oferta e BOE “MALBERTEX” shpk, dhe “UNIVERS PROMOTIONS” shpk është e kualifikuar sipas vendimit të KPP, por si AK mendojme se si ofertë anomalisht e ulët që nuk krijon bindjen se është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Materialin e argumentuar e gjeni në procesverbalin fizik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.2.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën përcjellëse me nr. 69/14 prot., datë 02.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 264/3 prot., datë 04.02.2026 me objekt “Vendim”, (Vendimi i KSHA nr. 69/11 datë 02.02.2026), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së BOE ankimues “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, me objekt “Vendim”, (Vendimi i KSHA nr. 69/13 datë 02.02.2026), ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e BOE ankimues “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO më datë 02.12.2025, nëpërmjet SPE, i është drejtuar BOE ankimues me kërkesë që brenda 3 ditëve pune, të paraqesë pranë autoritetit shpjegime, në lidhje me ofertën anomalisht të ulët, të cilat duhet t’i argumentonte dhe dokumentonte edhe me prova shkresore.

III.2.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën përcjellëse me nr. 69/14 prot., datë 02.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 264/3 prot., datë 04.02.2026 me objekt “Vendim”, (Vendimi i KSHA nr. 69/11 datë 02.02.2026), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së BOE ankimues “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, me objekt “Vendim”, (Vendimi i KSHA nr. 69/13 datë 02.02.2026), si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor më datë 02.12.2025, BOE ankimues “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk, ka ngarkuar në SPE më datë 05.12.2025 argumentimin, me qëllim, justifikimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.2.3. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose*

shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]

III.2.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; - Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.2.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të BOE ankimues “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 98,430,000 lekë pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta

sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis. Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: *b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijjë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si

dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.2.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, informacionit të dërguar nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave si edhe arsyes së skualifikimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

Së pari, Komisioni i Vlerësimit të Oferatve në arsyen e cituar për ri-skualifikimin e BOE ankimes, referuar raportit të auditit të gjeneruar nga sistemi i prokurimit elektronik *“Ne baze te vendimit nr.1702/2025 te KPP me nr prot,2645/11, date 18.11.2025 Prot me tonen me nr,187/101, date 21.11.2025 Sipas rivlersimit date 30.12.2025 me nr prot 187/112 -oferta e BOE “MALBERTEX” shpk, dhe “UNIVERS PROMOTIONS” shpk është e kualifikuar sipas vendimit të KPP, por si AK mendojme se si ofertë anomalisht e ulët që nuk krijon bindjen se është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Materialin e argumentuar e gjeni ne procesverbalin fizik”*.

Komisioni konstaton se, si në arsyen e ri-skualifikimit të dhënë në raport auditit ashtu edhe në dokumentin “procesverbalin fizik” (Proces verbal rivlerësimi nga KVO me nr. 187/112 prot., datë 30.12.2025), e cituar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nuk evidentohet asnjë argumentim ligjor apo financiar apo teknik mbi mospërmbushjen kushteve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis.

Së dyti, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në trajtimin e formularit të Ankesës së BOE ankimes në shkresën me nr. 69/13 datë 02.02.2026, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë. Nga shqyrtimi i informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor, konstaton se, nuk evidentohet asnjë argumentim ligjor apo financiar apo teknik mbi mospërmbushjen kushteve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis. Në lidhje me këtë pretendim (ofertë anomalisht të ulët), e cila është edhe arsyeja e ri-skualifikimit nga ana e KVO-së, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk ka dhënë asnjë argumentim.

Së treti, Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga pretendimet e BOE ankimues, arsyet së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, si dhe referuar trajtimit të formualrit të ankesës nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Anakesave, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, është në kushte të paqarta dhe në pamundësi për të vlerësuar mbi arsyet e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, konkretisht në vlerësimin e dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, sepse ky i fundit nuk ka dhënë apo evidentuar qartë se cili prej kushteve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nuk është argumentuar nga ana e BOE ankimues, duke krujjar një situatë procedurale jo të qartë, konfuze dhe jo të argumentuar qartë. Në këto kushte, autoriteti kontraktor ka vënë në pozita të paqarta dhe konfuze edhe vetë BOE ankimues duke e vënë në pozitë jo të qartë, në pamundësi për të argumentuar apo kundërshtuar vlerësimin e dhënë për këtë të fundit për arsyen e skualifikimit, në lidhje me argumentimin për ofertën anomalisht të ulët.

Akoma më tej, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “Sigurimi i ofertës” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe neni 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, si dhe nenit 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar.

Në këto kushte, nga sa u parashtrua dhe argumentua më lartë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të ri-kthejë përsëri, procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga statusi aktual në statusin e fazës së vlerësimit, sepse secili anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të evidentojë qartë dhe saktë, se cili prej kushteve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nuk është argumentuar nga ana e BOE ankimues.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”, qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me ankesën e administruar në datën 28.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 264/2026 protokoli, datë 28.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6288 e operatorit ekonomik “ARISA - KONFEKSION” Shpk, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma”

për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA”, me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A, mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “ARISA - KONFEKSION” Shpk, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se OE ankimues **nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare** për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.3.1. Në germën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: *“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.*

II.3.2. Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se, statusi i pagesës për ankesën me nr. 264/2026 protokoll, datë 28.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6288 e operatorit ekonomik “Arisa Konfeksion” shpk, rezulton **“Paparaqitur mandat pagesë”**. Me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP me shkresën nr. 264/5 prot., datë 09.02.2026 nga KPP ju kërkua informacion autoritetit kontraktor për sa më poshtë vijon:

... me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon të informohet në lidhje me administrimin e kësaj ankese pranë institucionit tuaj si dhe veprimet procedurale të kryera nga ana juaj sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në lidhje me plotësimin e të metave të ankesës...”.

II.3.3. Me shkresën nr. 264/6 prot., datë 16.02.2026 lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së OE “Arisa Konfeksion” Shpk, Sekori i Financës informon ndër të tjera se: *“ [...]”*

*Për ankesën me nr. 264/2026 protokoli, datë 28.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6288, OE “Arisa Konfeksion” Shpk, nuk ka paraqitur dokument bankar në seksion mandat pagese. Në vijim të shkresës tuaj janë kryer verifikime me raportin e datës 16.02.2026 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 11.02.2026, ku rezulton se, OE “Arisa Konfeksion” Shpk **nuk ka kryer pagesë** për ankesën e sipërcituar në favor të Komisionit të Prokurimit Publik” ...*

II.3.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 69/28 prot., datë 17.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 264/7 prot., datë 18.02.2026 me objekt “*Kthim përgjigje mbi kërkesën për informacion nr.264/5 prot., datë 09.02.2026*”, (Vendimi i KSHA), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatori ekonomik ankimes “Arisa Konfeksion shpk”, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë për shkak të **mosplotësimit të kushteve formale** siç është dokumenti bankar “mandat pagesa”, duke mos marrë parasysh këtë formular ankese.

III.3.5. Referuar pikës 2, të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar.

Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efijencës në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës me nr. 69/28 prot., datë 17.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 264/7 prot., datë 18.02.2026 me objekt “*Kthim përgjigje mbi kërkesën për informacion nr.264/5 prot., datë 09.02.2026*”, (Vendimi i KSHA), dërguar me shërbim postar, rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes komunikimit elektronik në adresën (konfeksionarisa@gmail.com) me datë 12.02.2026 i ka kërkuar OE “Arisa Konfeksion” Shpk, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar (më datë 12.02.2026) operatori ekonomik ankimues përmes komunikimit elektronik, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës.

Gjithashtu, me shkresën nr. 264/6 prot., datë 16.02.2026 lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së OE “Arisa Konfeksion” Shpk, Sekori i Financës informon ndër të tjera se: “ [...] Për ankesën me nr. 264/2026 protokollin, datë 28.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6288, OE “Arisa Konfeksion” Shpk, nuk ka paraqitur dokument bankar në seksion mandat pagese. Në vijim të shkresës tuaj janë kryer verifikime me raportin e datës 16.02.2026 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 11.02.2026, ku rezulton se, OE “Arisa Konfeksion” Shpk **nuk ka kryer pagesë për ankesën e sipërcituar në favor të Komisionit të Prokurimit Publik**” ...

Sa më sipër, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës, **rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.**

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK, me nr. 264/2026 protokolli, datë 28.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6288, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA ” me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk me nr. 228/2026 protokolli, datë 26.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6277, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk me nr. 252/2026 protokolli, datë 27.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6282, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.
4. Autoriteti kontraktor të ri-vlerësojë BOE ankimues “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, sipas konstatimeve në këtë vendim.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk për ankesën me nr. 252/2026 protokolli, datë 27.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6282.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

